

CRNA GORA

Opština Tuzi

Služba Predsjednika

Br.Nr:01-031/21-6/LS

Tuzi – Tuz , 30.04.2021.godine

MALI I ZI
Sherbimi i kryetarit

Në pajtim me nenin 99 paragrafi 1 pika 22 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi -dispozitat komunale”, nr. 024/29, 005/20), e në lidhje me nenin 6 dhe 7 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale”, br. 046/19), kryetari i komunës udhëzon,

THIRRJE PUBLIKE
ORGANIZATAVE JOQEVERITARE PËR PROPOZIMIN E PËRFAQËSUESIT/SES
PËR ANËTARË/RE TË KOMISIONIT PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NDAJ
OJQ-VE

Thirren të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Mal të Zi, me seli në Tuz, të propozojnë përfaqësuesin/en në përbërje të Komisionit për shpërndarjen e mjeteve ndaj OJQ-ve.

Kandidatin/en për anëtar të Komisionit mund ta propozojë OJQ-ja e cila plotëson kushtet në vijim:

- Të jetë e regjistruar në regjistrin e organizatave joqeveritare, së paku një vit para publikimit të thirrjes publike;
- Të ketë seli në territorin e komunës së Tuzit,
- Të ketë realizuar një ose më shumë projekte në periudhën paraprake, duke e dëshmuar përmes dorëzimit të kontratës mbi financimin, broshurave dhe ngjashëm;
- Që më shumë se gjysma e organeve menaxhuese të OJQ-së nuk janë anëtarë/e të organeve të partive politike, funksionar publik, shtetëror, nëpunës apo zyrtar lokal, udhëheqës ose të punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste, themelues i të cilit është shteti ose Komuna, duke e dëshmuar përmes deklaratës.

Organizata joqeveritare është e obliguar që krahas kandidatit/tes të propozuar të dorëzojë dëshmitë në vijim:

1. Kopjen e aktvendimit të vërtetuar mbi regjistrimin në regjistrin e organizatave joqeveritare;
2. Dëshmitë mbi projektet e realizuara ose aktivitetet për vitin paraprak, përmes dorëzimit të kontratës mbi financim, broshurave dhe ngjashëm;
3. Deklaratën e personit të autorizuar për përfaqësim dhe prezantim të OJQ-së që anëtarët e organeve drejtuese nuk janë anëtarë të organeve të partive politike, funksionar publik, shtetëror, nëpunës apo zyrtar lokal, udhëheqës ose të punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste, themelues i të cilit është shteti ose Komuna.

Kandidati/ja e OJQ-së për anëtar/e mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Malit të Zi dhe ka vendbanimin në territorin e Komunës së Tuzit,
- ka përvojë pune në hartimin dhe realizimin e projekteve,
- nuk është anëtar i organeve të partive politike, funksionar publik, shtetëror, nëpunës apo zyrtar lokal, udhëheqës ose të punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste, themelues i të cilit është shteti ose Komuna, duke e dëshmuar përmes deklaratës.

Organizata joqeveritare e cila propozon kandidatin/ten për anëtar/e të komisionit është i/e obliguar të dorëzojë:

1. Fotokopjen e vërtetuar të letërnjoftimit për kandidatin/ten të cilin/en e propozon;
2. Biografinë e kandidatit/tes me dëshmi mbi përvojën në hartimin dhe realizimin e projekteve;
3. Deklaratën e kandidatit/tes se nuk është anëtar/e i/e organeve të partive politike, funksionar publik, shtetëror, nëpunës apo zyrtar lokal, udhëheqës ose të punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste, themelues i të cilit është shteti ose Komuna;
4. Deklaratën e kandidatit/tes mbi pranimin e kandidaturës për anëtar të komisionit.

Dokumentacionin për propozimin e kandidatit/tes për anëtar/e të Komisionit që është shënuar në thirrjen publike, organizatat joqeveritare e dorëzojnë pranë Sekretariatit për vetëqeverisje lokale në zarf të mbyllur me shënimin “**propozim i kandidatit/es për anëtar/e të Komisionit të OJQ-së**”, përmes arkivit të Komunës së Tuzit ose përmes postës. Formulari për paraqitje mund të merret drejtpërsëdrejti në arkivin e komunës së Tuzit ose në web faqën e komunës www.tuzi.org.me
Propozimet për anëtar/e të komisionit dorëzohen më së voni deri më 10.05.2021.

KRYETARI,
Nik Gjaloshaj

